



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS  
ALBANIA



# /nevojat për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar

## /raport



Leave  
No One  
Behind

# /hyrje



Sistemet arsimore sot janë nën presion të vazhdueshëm për t'u përshtatur me nevojat në ndryshim të shoqërisë dhe ekonomisë. Shkollat, gjithnjë e më shumë, nxiten për të ofruar edukimin më të mirë të mundshëm dhe për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve pa dallim. Sot ekziston një konsensusi gjerë rreth faktit se, mësuesit janë agjentë kyç të ndryshimit, në procesin e krijimit të shkollave dhe klasave gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, prej kohësh, fokus i politikave arsimore është bërë cilësia e përgatitjes dhe zhvillimit profesional të mësuesve me qëllim përmbushjen e rolit të tyre.



Nxitja e arsimit gjithëpërfshirës është një nga prioritetet kryesore të reformimit të sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri. Edukimi dhe mbështetja gjithëpërfshirëse dhe, veçanërisht arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta, është përgjegjësi e çdo institucioni arsimor. Në këto kushte përgatitja e institucioneve arsimore, mësuesve ndihmës, punonjësve social e psikologëve shkollorë si dhe përfaqësuesve të komunitetit, që kanë përgjegjësinë të punojnë dhe kujdesen për fëmijët me nevoja të veçanta, është me rëndësi të veçantë dhe mbetet përgjegjësi e të gjithë atyre që mbështesin edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.



Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar ka vendosur si prioritet zhvillimin profesional të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara me synim ngritjen e një sistemi të mbështetjeje dhe nxitjeje të aftësive të tyre profesionale. Jo të gjithë mësuesit e angazhuar në këtë rol kanë aftësitë e duhura profesionale për të përballuar përgjegjësitë dhe detyrat që mbart roli që po kryejnë. Nevojat profesionale të tyre aktualisht duket se janë të konsiderueshme.



Zhvillimi profesional i mësuesve ndihmës, si i një rëndësie të veçantë, nuk mund t'i lihet rastësisë dhe spontanitetit. ASCAP me mbështetjen e UNDP, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas", të financuar nga Agjencia Zvicëranë për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), ka ndërmarrë një proces të identifikimit të nevojave të mësuesve ndihmës në të gjitha ZVAP-të e vendit. Ky proces i identifikimit dhe analizës së nevojave përfaqëson hapin e parë të vendimmarrjeve të mëtejshme apo ndërhyrjeve të nevojshme. Ai u mundësua përmes aplikimit online të një instrumenti të detajuar, i cili u vu në dispozicion të të gjithë mësuesve ndihmës që punojnë aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar. Analiza e të dhënave të grumbulluara, që paraqitet më poshtë, paraqet përmbledhtas të dhëna mbi gjendjen reale të aftësive, përvojave të grumbulluara dhe nevojave më të rëndësishme të këtij grupi.

# /metodologjia

## /procesi i përzgjedhjes

- Instrumenti u shpërnda tek 46 drejtues rrjeti të mësuesve ndihmës
- Drejtuesit e rrjetit e shpërndan tek anëtarërit e rrjetit të tyre.

## /instrumentet e përdorura

- 1 instrument
- 11 pohime me shkallë likert
  - 1-Kurrë
  - 2-Rrallë
  - 3-Ndonjëherë
  - 4-Shpesh
  - 5-Gjithmonë
- 23 pohime të tjera
- plotësimi online

## /periodha e realizimit

- Shpërndarja e instrumentit qershor 2020
- Mbledhja e të dhënave deri shtator 2020
- Përpunimi i të dhënave shtator 2020

## /parimet etike

- Mësuesit u informuan për qëllimet e vëzhgimit;
- U informuan mbi mënyrën se si do të dilnin rezultatet e vëzhgimit;
- Plotësimi i instrumentit ishte me dëshirë;
- U ruajtën të dhënat personale sipas akteve ligjore në fuqi.

## /linku i instrumentit



**PYETËSOR PËR MËSUESIT NDIHMËS**

**Përshëndetje!**  
Ky pyetësor bëhet për të marrë informacion mbi nevojat për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës që punojnë aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar dhe për të mbështetur këtë zhvillim bazuar në nevojat e data. Përgjigjet tuaja do të ndihmojnë për ta bërë sa më efektiv procesin e zhvillimit profesional dhe përmirësuar veprimtaritë e përbashkëta.

Ju lutem, ndihuni të lirë dhe plotësoni me sinqeritet të gjitha përgjigjet. Pyetësori është tërësisht anonim. Asnjë nga përgjigjet nuk do të referohet një mësuesi apo shkolle të caktuar. Rezultatet do të jenë të përgjithshme.

\* Required

Gjinia: \*

**46**

Drejtues rrjeti/mësues ndihmës

**555**

Mësues ndihmës

**601**

Total

# /metodologjia/kampioni

/pjesëmarrja

Percentages reflect monthly changes.


Mësues ndihmës



Cikle edukimi



Drejtuës rrjeti profesional



DRAP/ZVA




## ZVA me pjesëmarrjen më të lartë

- Tiranë ▲
- Elbasan
- Fier
- Durrës
- Divjakë

## ZVA me pjesëmarrjen më të ulët

- Sarandë-Konispol
- Kavajë
- Has
- Prrenjas
- Kukës
- Kolonjë ▼


## Shpërndarja sipas DRAP




# /metodologjia/kampioni

Të dhëna të përgjithshme

Zona e shkollës




Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara me të cilët punojnë




■ 1 (24.96%) ■ 2 (33.28%) ■ 3 (15.97%) ■ Mbi 3 (25.79%)


Vjetërsia në punë si mësues/e ndihmës



Lloji i shkollës



Gjinia



■ Femër (90.02%) ■ Mashkull (9.98%)


84.5% e mësuesve ndihmës janë të shpërndar në Arsimin Bazë (AF+AMU)

# /gjetjet/të dhëna mbi zhvillimin profesional


Trajnime me fokus pedagogjinë speciale gjatë kohës që punojnë si mësues/e ndihmës/e



## Mbështetjet dhe mundësitë për zhvillim profesional




## Mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit të jashtëm




# /gjetjet

Arsyeja që gjatë kësaj periudhe nuk kanë marrë pjesë në trajnime




## Deklarime të mësueve ndihmës



**/komisioni multidisiplinor pranë ZVA-së ka vlerësuar shkallën e vështirësisë së nxënësit/ve me të cilin/ët ju punoni dhe ka përcaktuar nevojat arsimore të tij.**

# /gjetjet


## Deklarime të mësueve ndihmës




■ Gjithmonë (77.04%) 
 ■ Shpesh (11.65%) 
 ■ Ndonjëherë (3%) 
 ■ Rrallë (0.83%) 
 ■ Kurrë (7.49%)

**/drejtori i shkollës ku ju punoni, bashkëpunim me Komisionin e Shkollës për fëmijët me AK, ka përcaktuar numrin e orëve që ju si mësues ndihmës do të keni për çdo fëmijë me AK.**

**/ju njihni mirë dhe zbatoni pedagogjinë me në qendër fëmijën si dhe veçoritë e punës me fëmijët me AK.**



■ Gjithmonë (17.8%) 
 ■ Shpesh (80.87%) 
 ■ Ndonjëherë (1.16%) 
 ■ Kurrë (0.17%)



■ Gjithmonë (27.37%) 
 ■ Shpesh (36.81%) 
 ■ Ndonjëherë (33.16%) 
 ■ Rrallë (2.16%) 
 ■ Kurrë (0.5%)


**/ju bashkëpunoni me mësuesin e lëndës për hartimin e programit edukativ individual (PEI) për fëmijën me AK dhe për vlerësimin e nxënësit me AK, sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit të vendosura në PEI.**




# /gjetjet

Deklarime të mësueve ndihmës

**/ju bashkëpunoni me psikologun dhe punonjës social për hartimin e programit edukativ individual (PEI) për fëmijën me AK dhe për vlerësimin e nxënësit me AK, sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit të vendosura në PEI.**




■ Gjithmonë (74.71%) ■ Shpesh (16.31%) ■ Ndonjëherë (4.83%) ■ Rrallë (2.66%)  
■ Kurrë (1.5%)



■ Gjithmonë (68.89%) ■ Shpesh (24.79%) ■ Ndonjëherë (4.66%) ■ Rrallë (1%)  
■ Kurrë (0.67%)

**/ju bashkëpunoni me prindin për hartimin e programit edukativ individual (PEI) për fëmijën me AK dhe për veprimtaritë që zhvillohen në klasë dhe mund të zhvillohen në shtëpi.**


**/keni zhvilluar veprimtari mësimore në klasë ose jashtë saj me praninë dhe bashkëpunimin e prindit të fëmijës me AK.**



■ Gjithmonë (19.3%) ■ Shpesh (44.76%) ■ Ndonjëherë (28.45%) ■ Rrallë (3.83%)  
■ Kurrë (3.66%)

# /gjetjet


## Deklarime të mësueve ndihmës




■ Gjithmonë (84.03%) ■ Shpesh (14.48%) ■ Ndonjëherë (1.33%) ■ Rrallë (0.17%)

**/ju informoni rregullisht prindin/kujdestarin e fëmijës me AK për progresin mësimor dhe zhvillimor të tij përmes takimeve të rregullta që zhvillohen në shkollë.**

**/ju njihni dhe bashkëpunoni me partnerë të tjerë, të specializuar për punën me fëmijët me AK, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në komunitetin pranë shkollës tuaj.**



■ Gjithmonë (5.82%) ■ Shpesh (3.66%) ■ Ndonjëherë (31.28%) ■ Rrallë (37.11%)  
■ Kurrë (22.13%)




■ Gjithmonë (7.5%) ■ Shpesh (17.97%) ■ Ndonjëherë (27.44%) ■ Rrallë (19.97%)  
■ Kurrë (27.12%)

**/ju bashkëpunoni me qendrat e shërbimit social në qytetin tuaj për të përfituar profesionalisht nga specialistët që punojnë aty.**

# /gjetjet

## Deklarime të mësueve ndihmës

**/ju ndjeheni i aftë të asistoni nxënësin me AK sipas nevojave gjatë procesit mësimor si brenda ashtu jashtë klase, për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tij/saj sa më të plotë në veprimtaritë mësimore dhe shkollore.**



■ Gjithmonë (73.04%) ■ Shpesh (25.79%) ■ Ndonjëherë (1.16%)

## Të dhëna përshkuese të deklaramë të mësueve ndihmës



**4.79**



Njohja dhe zbatimi i pedagogjisë me në qendër nxënësin



**4.3**


Mesatarja e përgjithshme



**3.43**




Bashkëpunimi me qendrat e shërbimit social




# /gjetjet


Tematikat me te nevojshme për të cilat janë të interesuar të trajnohen në vazhdimësi




# /përfundime




MN janë të pranishëm në institucionet e arsimit parauniversitar si në zona urbane ashtu edhe në zonat rurale. Ato janë të angazhuar në të gjithë institucionet arsimore pavarësisht nga numrin i nxënësve apo vendndodhja e tyre; Pjesa më e madhe e MN (rreth 60% e tyre) punojnë dhe mbështesin 1-2 fëmijë me aftësi të kufizuara; Rreth 25% e mësuesve ndihmës mbështesin dhe punojnë me më shumë se tre fëmijë me aftësi të kufizuara;



Gati 50% e mësuesve ndihmës janë të rinj në këtë pozicion, me një eksperiencë deri në 3 vite si mësues ndihmës; Pothuajse të gjithë mësuesit ndihmës punojnë në arsimin e detyruar. Pothuajse të gjithë mësuesit ndihmës janë femra.




Mësuesit ndihmës të angazhuar në sistemin arsimor parauniversitar janë përpjekur të ndjekin trajnime për zhvillimin profesional të tyre. Format më të frekuentuara të trajnimit janë takimet e rrjeteve profesionale dhe takimet e shkëmbimet më mësues të tjerë të së njëjtës shkollë. Gjithashtu ato kanë interes dhe janë përpjekur të ndjekin trajnime të akredituara të ofruara nga agjenci që janë akredituara nga MASR.




Mësuesit ndihmës vlerësojnë si një institucion të rëndësishëm Komisionin e shkollës për fëmijët me aftësi të kufizuara i cili mundëson orët e nevojshme për të mbështetur fëmijën në nevojë dhe planifikimin e veprimtarive edukative për të.


# /përfundime



Mësuesit ndihmës e shohin bashkëpunimin me mësuesin e klasës me një rëndësi të veçantë në hartimin e PEI-it dhe vlerësimin e nxënësit me AK sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit. Gjithashtu, Bashkëpunimi me prindërit e fëmijës me AK, konsiderohet nga mësuesit ndihmës si faktor i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit dhe progresit të fëmijës.



Mësuesit ndihmës nuk kanë pasur mundësi mjaftueshëm dhe nuk kanë shfrytëzuar sa duhet bashkëpunimin me partnerë të tjerë të specializuar për punën me fëmijët me AK në komunitetin e tyre, duke përfshirë këtu edhe qendra e shërbimit social për të përfituar profesionalisht nga specialistët që punojnë aty.



Nevoja për trajnim dhe aftësim profesional e mësuesve ndihmës duket të jetë shumë e madhe. Ata pohojnë dhe vlerësojnë të nevojshme në nivel të lartë një sërë tematikash si: Metoda dhe strategji të mbështetjes në klasë të fëmijëve me AK; Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë për të mbështetur fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta; Dokumentacioni i nevojshëm që mban mësuesi ndihmës; Hartimi i programeve edukative individuale (PEI) efektiv; Karakteristikat kryesore (format e manifestimit) të llojeve të ndryshme të pa(aftësive); e të tjera që janë cilësuar më sipër në raport.

# **/nevoja për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar**

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Rruga "Naim Frashëri"  
Nr. 37  
Tirana  
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

